



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

29 dhjetor 2021

C-IV-13-1578

Ankuesi

H S Prishtinë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 29 dhjetor 2021, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN048-0102, datë 29 korrik 2013, si i drejt dhe i bazuar në ligj.**
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 21 gusht 2013, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRN048-0102, të datës 29 korrik 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ka kërkuar që të kompensohet për pagat e papaguara, në shumë prej 1,982.50 €, për periudhën mars-dhjetor 2003, nga NSH “Energoinvest”. Me vendimin e kundërshtuar, ankuesit i është pranuar shuma prej 1,327.90 € për muajt mars-shtator 2003, ndërsa i është refuzuar shuma prej 654.57 €, për muajt tetor-dhjetor 2003. Ankuesi pohoi se në vendimin e kundërshtuar shuma prej 654.57 € i është refuzuar si e pabazuar dhe shtron pyetjen se prej nga kjo bazë, si kanë mundur me nxjerrë shumën prej 175.21 € që i është aprovuar, kur ndërmarrja nuk ia ka paguar sipas dëshmive pagat mujore prej 204.50 €. Po ashtu, ankuesi pohoi se gjykata ka herë është dashtë ta shqyrtoj dhe të bie vendim në dobi të punëtorëve për të mos ardhur gjer te kjo që tani me kaq vonesë edhe po kërkohet. Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar kopjen e vendimit të kundërshtuar dhe listë pagesën për muajt mars-dhjetor 2003.

Me 26 tetor 2017, e paditura AKP-ja parashtrori mbrojtje, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se sipas nenit 7 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe nenin 23 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033, ankuesi ka detyrimin dhe barrën e provës. Po ashtu e paditura pohoi se çdo kërkesë për paga të paguara duhet të mbështetet në prova që vërtetojnë se ankuesi realisht ka punuar dhe nuk është paguar një detyrim i tillë i ndërmarrjes. Më tej ankuesi pohoi se pretendimi i ankuesit se AL i ka refuzuar shumën prej 654.57 € pa ndonjë arsye është plotësisht i pathemeltë. Shuma prej 654.57 € është diferenca ndërmjet shumës totale të kërkuar nga ai në dëshminë e kërkesës në likuidim pra shuma prej 1,982.50 € dhe shumës neto të pranuar nga AL në llogari të ankuesit për paga për periudhën mars-shtator. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar, kurse vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Me vendimin e kundërshtuar PRN048-0102 të datës 29 korrik 2013, ankuesit H S i është aprovuar si pjesërisht e bazuar kërkesa për kompensim për paga të pa paguara. Me vendimin e lartcekur ankuesit i është njohur shuma prej 1,327.90 në emër të pagave të pa paguara për muajt mars-shtator 2003 dhe kërkesa në shumë prej 175.21 në emër të tatimeve të pa paguara. Ndërsa i është refuzuar kërkesa për pagat e pa paguara për muajt tetor-dhjetor 2003 në shumë prej 654.57 €, me arsyetimin se ankuesi letrën për ndërprerjen e marrëdhënies së punës e ka pranuar në muajin shtator të vitit 2003.

Në këtë rast ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se ka qenë punëtor i NSH në muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2003, për të cilët i kërkon pagat. Gjykata gjen se asetet e NSH Energoinvest janë shitur me 06 shtator 2003 dhe si pasojë e kësaj është edhe përfundimi i punësimit për të gjithë punëtorët të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune me NSH deri në atë kohë. Nga kjo gjykata gjen se ankuesi nuk ka qenë punëtor i NSH për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2003 dhe se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për pagat e pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore për ankesën e parashtruar.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar